



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Raporti Vjetor 2019

Rrjeti i Grave të Kosovës

Raporti Vjetor 2019



© Rrjeti i Grave të Kosovës, maj 2020

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar burimin.

Ky raport është përgaditur nga anëtarët e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), të përkrahura nga Agjencioni Austriak për Zhvillim, Fondacioni Kvinna till Kvinna, dhe Bashkimi Evropian, si përgjegjësi e RrGK-së për të raportuar tek organizatat anëtare të saj. Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e RrGK-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të donatorëve të lartëpërmendur.

www.womensnetwork.org



Përmbajtja

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RrGK-së	I
HYRJE	4
Vizioni ynë	4
Misioni ynë	4
Strategjia jonë.....	4
Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së.....	5
Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë.....	6
<i>Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave</i>	17
GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE.....	19
Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore.....	20
Përmirësohet institucionalizimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) në Kosovë	28
Rritja e pjesëmarrjes së OShCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE.....	30
<i>Përmirësimi i zbatimit të PVGj II</i>	33
Përmirësimi i projektimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II.....	34
Përmirësimi i transpozimit të <i>Acquis</i> të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës.....	35



Të Drejtat e Grave në Kujdesin Shëndetësor.....	36
Përmirësimi i reagimit të zyrtarëve publikë dhe institucioneve shëndetësore ndaj shkeljes së të drejtave shëndetësore të grave.....	36
Rritja e qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor.....	37
Përmirësimi i politikave dhe procedurave për adresimin e ngacmimit seksual.....	48
Përmirësimi i Qasjes në Edukim Cilësor dhe të Ndjeshëm Gjinnor.....	55
VLERËSIMI I PUNËS SË RrGK	55
RAPORTI FINANCIAR I RrGK PËR.....	57
RRETH NESH	66
Bordi Drejtues i RrGK	66
Bordi Këshillëdhënës i RrGK	66
Stafi i RrGK në vitin 2019	66
Hulumtuesit dhe anketuesit e RrGK	68
Përkrahësit/et individual/e të RrGK	69
Organizatat Anëtare të RrGK-së	70



LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RrGK-së

Të dashura organizata anëtare të Rrjetit të Grave të Kosovës, përkrahës individual dhe institucional, si dhe përkrahës të tjerë të punës sonë tash më se të dy dekadave,

Po e lëmë pas edhe një vit shumë dinamik për avancimin e drejtave të grave dhe vajzave në Kosovë. Me krenari mund të përsërisim se Rrjeti dhe misioni saj është një shembull mobilizimi dhe ndikimi, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë, në rajon dhe në nivel ndërkombëtar. Do të përmendoj këtu për shembull pjesëmarrjen e Drejtores Ekzekutive, Igballë Rogova, si anëtare në Bordin Këshillues të NATO's dhe përfaqësimin e Kosovës për zbatimin e Rezolutës 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, fakte që dëshmojnë se edhe në nivele të larta të përfaqësimit ndërkombëtar është njohur përvoja dhe ekspertiza e krijuar në Kosovë.

Puna e zellshme e stafit të Rrjetit, që nuk do të doja ti veçoja individualisht për të mos harruar dike, nëpërmjet projektit të fondeve për gratë si dhe menaxhimin e granteve me kredibilitet të lartë profesional dëshmon për një reputacion dhe autoritet, lider të shoqërisë civile në Kosovë në menaxhimin dhe ofrimin e mundësive të shumta për punësim dhe aktivitete për OJQ-të e grave në Kosovë. Besoj se në këtë drejtim Rrjeti vazhdon të tregohet si një prej partnerëve më të besueshëm të shoqërisë civile dhe me stafin e vet të përkushtuar e profesional dhe punëtor vazhdon të jetë një autoritet me reputacion të lartë.



Poashtu edhe shumë iniciativa të tjera për ndryshimin e ligjeve së fundmi, si ndryshimi i Kodit Penal të Kosovës që të përfshijë përkufizimin e dhunës në familje, ngacmimin seksual, sqarimin adekuat të dhunimit në martesë si dhe ndryshimet të një sërë politikash dhe kërkesash të vazhdueshme ndaj institucioneve të Kosovës, tregojnë se vullneti për ndryshime do të vazhdojë dhe do të na mobilizojë edhe për shumë vite që do të vijnë. Kërkesat që të kemi drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore, punësim dhe mundësi të barabarta të grave dhe vajzave në Kosovë por edhe monitorimi për zbatimin e kërkesave të ndryshme për barazinë gjinore në Kosovë do të mbesin një punë e palodhshme dhe sfidë e cila duhet të ketë vëmendjen tonë të vazhdueshme.

Sfidat janë aty dhe do të mbesin edhe për shumë kohë. Por kjo na mobilizon edhe më shumë në misionin dhe kërkesat tona. Derisa në Kosovë kemi sistem institucional i cili vazhdon të tolerojë dhunën ndaj grave me arsyetime dhe me fajësimin e viktimave dhe vazhdon të trajtojë kryesit e akteve të dhunës si të pandëshkueshëm, misioni për drejtësi gjinore në mes tjerash do të vazhdojë deri në zbatimin e kërkesave tona.

Misioni do të vazhdojë më i mobilizuar në mënyrë që të kemi këtë barazi sa më shpejtë, se qysh tani jemi vonë.



Do e përfundoj me thënien e Joss Whedon lidhur me barazinë se “Barazia nuk është vetëm koncept. Nuk është diçka për të cilën duhet të përpiqemi. Është domosdoshmëri. Barazia është si graviteti. Ne kemi nevojë që të qëndrojmë në këtë tokë si burra dhe gra, derisa misogjinia e paraqitur në çdo kulturë të kuptohet se nuk është pjesë e vërtetë e gjendjes njerëzore. Jobarazia krijon jetë jashtë ekuilibrit dhe kjo çekuilibëron shpirtin e çdo burri dhe gruaje që përballet me të. Ne kemi nevojë për barazi që tani.”

Përzemërsisht,

Ariana Qosaj - Mustafa



HYRJE

Vizioni ynë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) **parasheh** që në shtetin e Kosovës gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni ynë

Misioni i Rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RrGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve.

Strategjia jonë

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e saj, RrGK ka hartuar Strategjinë për periudhën 2019-2022 ([të cilën mund ta gjeni në faqen tonë të internetit](#)). Qëllimi i kësaj strategjie është që të drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2018 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, bordi drejtues, partnerët dhe palët tjera relevante. Kjo strategji e RrGK-së është e ndarë në gjashtë fusha programatike: I) Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë; II) Gratë në politikë dhe vendimarrje; III) Të drejtat



e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Jeta pa dhunë me bazë gjinore, V) Fuqizimi ekonomik i grave dhe VI) Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.

Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së

Çdo vit Rrjeti raporton te organizatat anëtare, te partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport është i ndarë në gjashtë pjesë në të cilat përfshihen objektivat afatgjata të rrjetit:

- Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë;
- Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
- Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor;
- Jeta pa dhunë me bazë gjinore;
- Fuqizimi ekonomik i grave;
- Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2019, lidhur me secilin nga këto programe. Pjesët e mëposhtme përmbajnë informata lidhur me progresin e arritur drejt çdo objektiwi dhe rezultati të pritur vetëm për vitin 2019. Raporti gjithashtu përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve, bordit të drejtoreve, bordit këshilldhënës, stafit, praktikantëve, vullnetarëve, anëtareve dhe përfituesve të granteve.

Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë

Qëllimi kryesor i kësaj objekteve është që të fuqizohet lëvizja feministe ekzistuese në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit. RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së kësaj objekteve, siç tregohet edhe nga indikatorët e mëposhtëm:

- RrGK ka zbatuar 55% të Strategjisë,
- Numri i përkrahësve individual është rritur nga 79 në 102,
- Gratë dhe burrat kanë ndërmarrë 10 nisma për të mbështetur lëvizjen e grave, duke dëshmuar kështu që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitet që të vazhdojnë këtë lëvizje, si dhe
- Anëtarët e RrGK-së dhe Lobit për Barazi Gjinore (Lobi) kanë vazhduar të jenë tejet aktive dhe të zëshme.

Për realizimin e këtij qëllimi afatgjatë, është arritur përparim në objektivat e renditura më poshtë:

Rritet solidariteti mes organizatave të grave

Përvoja e RrGK-së sugjeron se mbështetja dhe mirëmbajtja e solidaritet ndërmjet organizatave të grave është jetike në krijimin e një lëvizje feministe të qëndrueshme. RrGK ka shënuar përparim drejt arritjes së objektivave të vitit 2019, kjo dëshmohej nga 39 partneritete, koalicionet dhe nisma të përbashkëta të ndërmarra gjatë vitit 2019, prej tyre 27 nisma ndëretnike, gjithsej 129 sosh që nga viti 2015. E po ashtu edhe nga arritja e rezultateve të parapara, të cekura më poshtë:



Anëtarët e RrGK-së të informuara për nismat, aktivitetet dhe mundësitë për përfitim të fondeve. Këtë vit numri i anëtareve të RrGK-së u rrit nga 141 në 158 organizata. RrGK ka mbajtur katër takime të rregullta të anëtareve, me ç'rast 201 anëtarë të ndryshëm, partnerë dhe mbështetës ndanë informata dhe poashtu u informuan për aktivitetet që ishin duke zhvilluar nga RrGK dhe organizatat e tjera. Që nga vitit 2015, gjithsej 1,145 gra dhe burra kanë marrë pjesë në mbledhjet e RrGK-së. Përgjatë këtyre takimeve, anëtarët e RrGK-së luajtën një rol të rëndësishëm në zbatimin e përbashkët të strategjisë, në diskutimin e zhvillimeve socio-politike në vend, si dhe në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së RrGK-së.



Anëtarët e RrGK gjatë mbledhjes
tremujore të anëtarësisë, të mbajtur në
shtator në Prishtinë.

Më shumë aktiviste dhe aktivistë të përfshirë në lëvizjen e grave

Gjatë vitit 2019, RrGK ka angazhuar rreth 812 vajza dhe djem përmes punës vullnetare në Fondin e Grave të Kosovës (FGK), Lobin për Barazi Gjinore, si dhe në aktivitete të tjera. Kjo u ka dhënë atyre mundësi që të përfitojnë më shumë aftësi rreth organizimit, hulumtimit, avokimit, integritit të çështjeve gjinore në avokimet për të drejtat e njeriut, monitorimin e seancave gjyqësore, dhunës me bazë gjinore, si dhe çështjeve të tjera me të cilat përballen gratë në Kosovë. Angazhimi i të rinjve në këto përpjekje mund të ndihmojë në fuqizimin e lëvizjes feministe në Kosovë.

Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile

Në vitin 2019, RrGK ka qenë e përfshirë në 27 nisma ndëretnike. Rrjeti u ka ofruar mundësi për bashkëpunim ndëretnik organizatave që kanë përfituar grante përmes Fondit të Grave të Kosovës dhe përfitueseve të tyre, si dhe përmes Lobit për Barazi Gjinore. RrGK ka vazhduar partneritetet e saj ndëretnike në rajon përmes Koalicionit për Adresimin e Diskriminimit me Bazë Gjinore në Punë në Ballkanin Perëndimor, rrjet ky që synon integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), si dhe hulumtimin e mundësive për ngritje të fondeve për mbështetje të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Për më tepër, RrGK këtë vit është partnere në dy projekte të reja rajonale ndëretnike, duke u përqendruar në adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.



Është përmirësuar kapaciteti organizativ i RrGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të Rrjetit

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtarët e saj që e mbajnë të gjallë atë. Andaj, RrGK vazhdimisht mbështet anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre, përmes mentorimit dhe Fondit të Grave të Kosovës.

RrGK ka vazhduar zhvillimin e Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese (OACA) të partnerëve dhe organizatave që kanë përfituar grante. Bazuar në këto, RrGK ka bashkëpunuar me këto organizata për të krijuar Plane për Zhvillimin e Kapaciteteve, të përshtatshme për çdo organizatë, të cilat edhe i ka mbështetur gjatë fazës së zbatimit. Si rezultat, disa organizata kanë përmirësuar kapacitetet e tyre organizative dhe avokuese.

Puna e RrGK dhe e anëtareve të saj më e dukshme te partnerët potencial, aktivistët e huaja dhe te mbështetësit e mundshëm

RrGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGK-së, faqen e Facebook-ut, si dhe buletin elektronik mujor *Zëri i Grave Kosovare*. RrGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 18,018 sa ishin në vitin 2018 në 19.919 këtë vit. Në Twitter dhe Instagram numri i ndjekësve është rritur nga 780 në 995, përkatësisht nga 1,279 në 1,710. Buletini elektronik *Zëri i Grave*



Kosovare lexohet nga 570 persona nëpër botë. Gjatë vitit 2019 RrGK ka pasur 231 paraqitje mediale dhe ka dërguar gjithsej 32 reagime/kumtesa për media, duke përfshirë:

1. Sugjerimet e RrGK-së pasqyrohen edhe në rezolutën e BE-së për të Drejtat e Grave (5 shkurt 2019).
2. E mitura dhunohet, shantazhohet dhe i rezikohet shëndeti: i dyshuar kryesor një zyrtar policor (6 shkurt 2019).
3. Logoja e II vjetorit të Pavarësisë është diskriminuese, nuk përfaqëson gratë (11 shkurt 2019).
4. Letër falenderimi drejtuar Deputetëve për mbështetjen e buxhetit për strehimoret dhe gendrat ditore për viktimat e dhunës (21 shkurt 2019).
5. RrGK mirëpret dënimin me burgim të përjetshëm për vrasjen e gruas dhe vajzës (1 mars 2019).
6. Informatë - Koalicioni për Barazi diskuton: “Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në politikë” (18 mars 2019).
7. Koalicioni për Barazi diskuton për “Fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në politikë” (19 mars 2019).
8. Shoqëria civile reagon kundër deklarimeve të prokurorit Rexhep Maqedonci (27 mars 2019).
9. RrGK dhe Lobi në përkatje të Podrimqaku-Subashit (29 mars 2019).

10. Njoftim për Media: RrGK do të lansojë raportin "Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë" (10 prill 2019).
11. RrGK lanson raportin: Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë (11 prill 2019).
12. RrGK: Publikimi i fotografive të dhunimit, shkelje e dinjitetit të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë (16 maj 2019).
13. RrGK alarmohet nga sulmi i sërishëm ndaj gruas rome në Ferizaj (31 maj 2019).
14. Informatë për media- Nesër promovohet libri i Sevdije Ahmetit "Ditari i një gruaje të Kosovës" (6 qershor 2019).
15. Informatë për media-Nesër në Prizren vrapohet në mbështetje të të mbijetuarave të dhunës seksuale (7 qershor).
16. Ftesë për media: Hapja e ekspozitës "Dhuna nuk fshehet mrena mureve" (13 qershor 2019).
17. Rikujtim: Hapja e ekspozitës "Dhuna nuk fshehet mrena mureve" (14 qershor 2019).
18. RrGK përkrah punën e palodhshme dhe transparente të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës (18 qershor 2019).
19. RrGK kundër kthimit në rigjykim të rastit të vrasësit Pjetër Nrecaj (24 qershor 2019).
20. Ftesë për media- Në Gjiilan sot hapet ekspozita "Dhuna nuk fshehet mrena mureve" (27 qershor 2019).



21. [Organizatat e Shoqërisë Civile kërkojnë që Qehaja të mbahet përgjegjës për arsyetimin e dhunimit dhe qëndrimet homofobike](#) (1 gusht 2019).
22. [Rrjeti i Grave të Kosovës dënon shqiptimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj të dyshuarit Q.A. e konsideron atë të pamjaftueshëm](#) (16 gusht 2019).
23. [RrGK reagon ndaj dështimeve të njëpasnjëshme të institucioneve në mbrojtje të të mbijetuarave të dhunës në familje](#) (20 shtator 2019).
24. [RrGK bën thirrje: Votoni për më shumë gra në parlament](#) (24 shtator 2019).
25. [RrGK: Gjyqësori edhe njëherë dështon në mbrojtjen juridike të barazisë gjinore](#) (3 tetor 2019).
26. [Raporti i ri rajonal shfaq përhapjen e diskriminimit me bazë gjinore në punësim në Ballkanin Perëndimor](#) (4 tetor 2019).
27. [RrGK i bashkohet thirrjes për tërheqjen e çmimit Nobel për Handke](#) (11 tetor 2019).
28. [RrGK prezanton në Bruksel raportin e ri mbi diskriminimin me bazë gjinore në Ballkan](#) (16 tetor 2019).
29. [Fondi i Grave të Kosovës do të ndajë 66,429€ për 18 organizata anëtare të RrGK](#) (23 tetor 2019).
30. [19 vite pas, Rezoluta 1325 e OKB-së mbetet relevante për dialogun dhe drejtësinë në Kosovë](#) (30 tetor 2019).
31. [RrGK reagon kundër ri-viktimizimit të grave që përjetojnë dhunë në familje](#) (5 dhjetor 2019).
32. [Mes miqësh, RrGK mbajti Kuvendin e 17-të Vjetor të Anëtareve](#) (7 dhjetor 2019).



Më shumë anëtare kërkojnë fonde, planifikojnë në mënyrë efektive, udhëheqin organizata dhe ndërmarrin nisma avokuese efektive

Përmes FGK-së, RrGK ka ndarë gjithsej 16 grante, për 18 organizata anëtare të saj. Prej tyre, dy Grante në Partneritet për Ndryshim (deri në 8,000€) iu ndan katër organizatave dhe Grante Avokimi Individual (deri në 4,000€ dhe 5,000€) iu ndan 14 organizatave anëtare. Këtë vit, FGK është përkrahur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) përmes nismës së RrGK-së "Avancimi i të Drejtave të Grave" në vlerë prej 48,000€ dhe nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë nëpërmjet nismës së RrGK-së "Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në politikë" në vlerë prej 20.000€. Shuma e përgjithshme e ndarë është 66,430€. Grantet në Partneritet për Ndryshim kanë ndikuar në rritjen e bashkëpunimit midis organizatave anëtare, duke u mundësuar organizatave të rajoneve të ndryshme të Kosovës të bashkojnë forcat dhe të avokojnë së bashku. Bashkëpunime të tilla



RrGK përmes Fondit të Grave të Kosovës ka ndarë gjithsej 16 grante, për 18 organizata anëtare të saj në vlerë prej 66,429€

pritet të vazhdojnë edhe në të ardhmen përmes këtyre granteve. Për shembull, OJQ Rikotta në partneritet me organizatën Qendra e Gruas ATO zhvilluan nismën “Fuqizimi ekonomik dhe ngritja e kapaciteteve të grave në Prevallë dhe fshatrat përreth”. Ndërsa Udruženje Žena Povratnica Naš dom në partneritet me Qendra e Gruas për Zhvillim Rural zhvilluan iniciativën “Partneriteti për zhvillim (i mjedisit miqësor për zhvillim) të ndërmarrësisë së grave”. Përveç këtyre dy nismave në partneritet, nisma tjera të përkrahura nga RrGK, të cilat do të vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2020, janë:

- Femrat Aktive të Gjakovës (FAGJ) me iniciativën: “Zhvillimi i një sistemi ndër institucional të qëndrueshëm për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në komunën e Gjakovës”;
- OJQ “Svet Andjela” me iniciativën: “Gratë në fokus”;
- Iniciativa e Femrës Kosovare (IFK) me iniciativën: “Qasja e përmirësuar e grave fermere dhe ndërmarrëse të Komunës së Gjakovës në subvencionet komunale”;
- Down Sindrom Kosova me iniciativën: “Kuzhina X21”;
- Kosovo Advocacy Group (KAG) me iniciativën: “Pjesëmarrja e grave të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në politikëbërje”;
- Udruženje Poslovnih Žena WBA me iniciativën: "Indeksi i barazisë gjinore në vetëqeverisjen lokale në Mitrovicë të Veriut”;



- Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane me iniciativën: “Promovimi i punësimit përmes avancimit të shkathtësive të buta për gratë rome, ashkali dhe egjiptiane në Gjakovë”;
- Organizata Lulishtja me iniciativën: “Avokim për fuqizimin ekonomik të grave fermere në fshatrat e Malësisë së Gollakut”;
- Organizata Hareja me iniciativën: “MOS heshtni-Flisni”;
- Moravski Biser me iniciativën: “Harmonizim i normave tradicionale të trashëgimisë me kornizën ligjore”;
- Organizata për Reforma Lokale “Euloc” me iniciativën: “Promovimi i buxhetimit të drejtë gjinor nga qeverisja komunale në Viti”;
- Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes me iniciativën: “Ngritja e efikasitetit të shërbimeve sociale përmes dispozitave të Konventës së Stambollit”;
- Art Without Limit me iniciativën: “Festivali ndërkombëtar i filmit për personat me nevoja të veçanta”
- United Women’s Association me iniciativën: “Avokim i drejtë për punësim të grave”.



Këtë vit përfituesit e FGK-së ndërmorën 40 iniciativa avokuese falë mbështetjes së marrë nga FGK-ja. Në total, nga vjeshta e vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2019, gjithsej 21,028 persona kanë përfituar nga iniciativat e ndryshme të anëtareve të RrGK-së. Në vitin 2019, stafi i RrGK-së ka ofruar 1118 sesione monitorimi përmes emailit, telefonit si dhe takimeve individuale për përfitueset e fondit. Komisioni për Shqyrtimin e Granteve kontribuoi për përmirësimin e kapaciteteve të anëtareve duke shqyrtuar çdo aplikacion dhe duke ofruar këshilla praktike për aplikimet e radhës. Kjo do të ndihmojë anëtarët e RrGK-së që në të ardhmen të dorëzojnë aplikacione më të plotësuar te FGK, si dhe te donatorët e tjerë.

Ngriten kapacitetet e stafit të RrGK

RrGK ka vazhduar që të ofrojë mundësi për ngritje të kapaciteteve për stafin, duke përfshirë ato që ndërlidhen me komunikim, integrimin e perspektivës gjinore, sigurinë digjitale, praktikat më të mira online, si dhe anti-korrupsion e financa. Monitorim i punës u ofrua në çështjet e lidhura me avokimin te Bashkimi Evropian (BE); integrimin e perspektivës gjinore, shkrimin e koncept-dokumenteve; hartimin e strategjive avokuese; hartimin e raporteve; monitorimin dhe vlerësimin; hulumtimin si dhe aftësitë e të shprehurit në publik. Po ashtu, këtë vit RrGK ka angazhuar 73 vullnetarë në aktivitete të ndryshme.



Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave

Sado që disa iniciativa avokuese mund të ndërmerren në baza vullnetare, OShCG-të ende kanë nevojë për burime për të përkrahur shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon mbështetje, andaj RrGK vazhdoi përpjekjet e saj në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendorë dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe në rajon. Falë avokimit në vitin 2019, RrGK takoi disa financues si dhe dërgoi analiza të shkurta të politikave për t'i vetëdijesuar ata lidhur me nevojat financiare të organizatave të grave. Avokimi i përmendur më poshtë kontribuoi në sigurimin e burimeve shtesë për organizatat e grave në Kosovë dhe rajon.

Përmirësohet zbatimi i Strategjisë së RrGK-së për Ngritje të Fondeve

RrGK ka filluar të hulumtojë dhe të krijojë një Strategji të Filantropisë, e cila do të identifikojë forma inovative dhe alternative për mbështetje të fondeve në nivel lokal, kjo përveç fondeve në nivel ndërkombëtar, fonde të cilat mund të mbështesin RrGK-në dhe organizatat anëtare të saj në aspektin afatgjatë. RrGK ka vëzhguar disa mundësi filantropie që ekzistojnë në botë, e veçanërisht ato në rrethana të ngjashme me Kosovën. Për ta punuar këtë strategji, Rrjeti po ashtu ka shikuar strategjitë që janë përdorur në Kosovë. Po ashtu, në mënyrë që të mbështetet më shumë mbledhja e fondeve online, janë bërë disa hapa edhe në faqen e internetit të RrGK-së. Sa u përket rezultateve, RrGK ka rritur kursimet në Fondin e Qëndrueshmërisë nga 3,263€ në vitin 2018 në 3,844€ në vitin 2019.



Përmirësimi i njohurive dhe mirëkuptimit midis organeve përkatëse të BE-së dhe donatorëve të tjerë në lidhje me llojet e mbështetjes që u nevojiten OShCG-ve të ndryshme

RrGK ka udhëhequr dhe koordinuar hulumtimin mbi financimin e të drejtave të grave, i cili u realizua nga organizatat e të drejtave të grave në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (BP): Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi, për të ekzaminuar trendet e financimit të të drejtave të grave dhe barazinë gjinore në BP. Hulumtimi kontribuon në: I) përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit në lidhje me fondet për grupet dhe lëvizjet për të drejtat e grave (OShCG-të); dhe II) përmirësimin e njohurive ndërmjet financuesve në lidhje me nevojat aktuale të OShCG-ve dhe llojet e modaliteteve të financimit që më së miri i adresojnë nevojat e tyre. Për më tepër, hulumtimi ofron një pasqyrë të trendeve që ndikojnë në financimin e OshCG-ve; dhe mundësi për strategji bashkëpunuese për mobilizimin e burimeve midis donatorëve dhe OshCG-ve. Ky hulumtim është bërë me metodën e përzier, që përfshin hulumtim në zyrë, intervista me 241 OShCG, si dhe intervista me 71 donatorë. Raporti i cili do të lansohet gjatë vitit 2020 do të ofrojë informata të detajuara lidhur me fondet në Ballkanin Perëndimor dhe nevojat e OshCG-ve për fonde. Përveç këtij hulumtimi, RrGK ka publikuar dy analiza të shkurta të politikave që përmbajnë rekomandime për përmirësimin e qasjes së OshCG-ve në fonde: *Duke ndjekur zotimet e Bashkimit Evropian sa i përket barazisë gjinore: Mësimet e nxjerra nga PVGJ II për të informuar PVGJ III, dhe Një qasje e përgjegjshme gjinore për*

financimin e jashtëm të BE-së. Këto dokumente u ndanë me përfaqësuesit e Parlamentit Evropian, Komisionit Evropian, Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian, si dhe akterë të tjerë të interesuar.

Përmirësimi dhe ngritja e vetëdijes institucionale dhe publike për zvogëlimin e tatimeve, si mbështetje për punën e rëndësishme të grupeve për të drejtat e grave

Si pjesë e Strategjisë së Filantropisë e po ashtu edhe e hulumtimit rreth fondeve të OShCG-ve, RrGK ka konsultuar kornizën ligjore për financimin e shoqërisë civile në Kosovë, si hap i parë drejt propozimit të rekomandimeve për përmirësimin e kornizës ligjore përkatëse. Lidhur me koordinimin e avokimeve të përbashkëta në të ardhmen, RrGK gjithashtu ka diskutuar edhe me OShCG-të e kësaj fushe.

GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje, në nivelin lokal dhe atë qendror. RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij qëllimi.

Në mes të tjerash, avokimi i RrGK-së kontribuoi në pjesëmarrjen e më shumë grave të zgjedhura në zgjedhjet parlamentare të tetorit 2019. Nga 39 gra të zgjedhura, 26 u zgjedhën direkt, pa kuotë gjinore,



një rritje prej 47% nga zgjedhjet e kaluara në 64% tani. Për më shumë, përqindja e deputeteve gra u rrit nga 32% në 32.5%. Po ashtu, përqindja e grave shqiptare përfaqësuese në parlament u rrit për 1.7%.

Një tregues tjetër i përmirësimit të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në procese vendimmarrëse gjatë vitit 2019, janë edhe 12 politikat e ndryshuara për të paraqitur prioritetet e grave, integrimin e perspektivës gjinore ose përputhshmërinë me Ligjin për Barazi Gjinore (LBGj). Që kur RrGK filloi që ti gjurmojë këto informata, Rrjeti, anëtarët e saj si dhe Lobi për Barazi Gjinore kanë arritur që suksesshëm të avokojnë për ndryshimin e 151 politikave për përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave, në nivel lokal dhe qendror.



Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore

Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, anëtarët e RrGK-së rritën numrin e qytetarëve të ndryshëm, posaqërisht gra që morën pjesë në politikë dhe procese vendimmarrëse nga 1669 në 2035 deri në vitin 2019. Për më tepër, RrGK dhe anëtarët e Lobit për Barazi Gjinore mbështetën 534 gra nga mosha, etniciteti, aftësitë dhe zonat gjeografike të ndryshme të marrin pjesë në politikë dhe vendimmarrje



përgjatë vitit 2019. RrGK, mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë, bashkëpunoi veçanërisht ngushtë me Organizatën e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës (OPDMK) dhe Ruka Ruci për rritjen e pjesëmarrjes në politikë dhe vendimmarrje të rreth 49 grave me aftësi të ndryshme dhe 173 grave nga komuniteti serb. Tutje, gjatë vitit 2019, RrGK arriti rezultatet e mëposhtme drejt këtij qëllimi.

Koalicioni për Barazi funksional në nivel lokal dhe qendror

Në qershor të vitit 2018, u themelua Koalicioni për Barazi, i përbërë nga gratë në politikë nga niveli qendror dhe lokal dhe nga organizatat joqeveritare të udhëhequra nga gratë. Koalicioni ka për qëllim të mbështesë anëtarët, të cilat përkrahin dhe fuqizojnë njëra tjetrën në përmirësimin e pozitës së gruas në politikë, vendimmarrje dhe avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Pjesëmarrëset u zotuan se do të punojnë drejt përmbushjes së këtij qëllimi të përbashkët, pa marrë parasysh preferencat politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësinë, religjionin, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik.



Takimi i Koalicionit për Barazi i cili u mbajt më 19 mars 2019 për të diskutuar “Fuqizimin e Pjesëmarrjes së Grave në Politikë”

Më 19 mars 2019, RrGK ka mbajtur takimin e Koalicionit për Barazi me rreth 85 pjesëmarrës, duke përfshirë këtu anëtare të RrGK-së, deputete, ministre, organizata ndërkombëtare si dhe mbështetës të tjerë. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësues të misionit të BE në Kosovë dhe Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Annette Fath Lihic, Këshilltare Kryesore Politike/Koordinatorë Ekzekutive, Zyra e Përfaqësueses së Posaçme të BE-së në Kosovë, në fjalën e saj ka bërë thirrje për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe ka vlerësuar se problemi kryesor mbetet mungesa e zbatimit të ligjeve. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë diskutuar ide lidhur me vazhdimin e zbatimit të Strategjisë së Koalicionit.

Gjatë këtij viti, anëtarët e Koalicionit për Barazi ndërmorën nismën e përbashkët për zgjedhjen e grave në parlament, pjesëmarrjen e tyre në qeverinë e re si dhe për buxhetin e strehimoreve.

Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë vazhdon punën

Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë (*nga këtu e tutje Lobi*) që u themelua në vitin 2014, bashkon gratë e politikës dhe ato të shoqërisë civile për të avokuar në nivelin qendror dhe atë lokal për përparimin drejt arritjes së barazisë gjinore. Lobi ka vazhduar të funksionojë në 27 komuna. Numri i grave të përfshira është rritur nga 400 në vitin 2015, në 597 në vitin 2019. Së bashku, ato ndërmorën 62 iniciativa avokuese në nivel komunal dhe qendror në vitin 2019, duke kontribuar në ndryshimin e 12 politikave gjatë këtij viti.

Gjatë këtij viti, Lobi ka mbajtur dy takime. Në mbledhjen e parë të mbajtur më 11 shkurt, pjesëmarrës ishin 26 përfaqësues të Lobit me qëllim që të planifikohen dhe të ideohen strategji për



fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në proceset vendimmarrëse në Kosovë. Pasiqë ishte takimi i parë i vitit, pjesëmarrësit ndanë së bashku objektivat për vitin 2019. Kurse, takimi i dytë u mbajt më 22 nëntor, gjatë të cilit raportuan 51 anëtarë për iniciativat e suksesshme dhe zbatimin e objektivave të vitit 2019. Duke pasur parasysh që shumica prej tyre ishin të angazhuar në fushatën “Voto për më shumë gra në Parlament”, ata ndanë përshtypjet nga vizitat derë më derë. Një koment i përsëritur ishte rritja e solidaritet ndërmjet grave dhe roli i Lobit në këtë proces.

Ngritja e kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave

Takimet e lartpërmendura si dhe punëtoritë e mbajtura zhvilluan edhe më tej kapacitetet e grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira dhe duke i përmirësuar aftësitë e tyre avokuese. Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballe Rogova, ka mbajtur 1,758 seanca të mentorimit me grupet e Lobit nëpër Kosovë, përmes vizitave nëpër komuna, thirrjeve telefonike apo e-mailit. Këto seanca shërbyen për të fuqizuar anëtarët e Lobit në avokimin e tyre për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. RrGK nuk i sheh apo trajton anëtarët e Lobit si anëtare të partive politike, por më tepër si udhëheqëse në komunat e tyre. Drejtorja Ekzekutive gjithashtu ishte e pranishme në ngjarjet e tyre, promovoi nismat e tyre, mbështeti ato në avokim duke iu bashkuar në takimet me zyrtarët lokal, si dhe duke i ndihmuar në tejkalimin e sfidave gjatë avokimeve të tyre drejt barazisë gjinore.



Rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e harmonizimit të Ligjit për Barazi Gjinore me ligjet e tjera relevante

RrGK-ja ka vazhduar të avokojë për përafrimin e Ligjit për Barazi Gjinore me ligjet e tanishme zgjedhore përmes avokimit të zyrtarët në Kosovë në bashkëpunim me përfaqësuesit e BE-së. RrGK në bashkëpunim me organizatat anëtare ka ndërmarrë fushatën “Voto për më shumë Gra në Parlament” duke bërë thirrje për përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019. Kjo fushatë e mbështetur nga BE-ja u realizua në komunitete në Kosovë. Për pesë ditë, në më shumë se 15 komuna, duke përfshirë edhe ato me shumicë serbe, vullnetarët e organizatave anëtare diskutuan dhe shpërndanë broshura për votuesit. Për më tepër, Drejtorja Ekzekutive ka pasur disa takime gjatë këtij viti me zyrtarë dhe përfaqësues të ndryshëm, për të bërë thirrje për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe harmonizimin e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme me të.



*Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së
gjatë takimit me përfaqësues të
Misionit të Bashkimit Evropian
për Vëzhgimin e Zgjedhjeve*

Më 23 tetor, Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së ishte pjesë e *Bisedat Gjinore të BE-së: “Gratë dhe Qeverisja”*, sesion debatues dy-orësh i përqendruar në rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore në të gjitha sferat e jetës, me theks të veçantë në procesin zgjedhor. Pjesëmarrësit përmendën nevojën



për përfshirje të grave në politikë dhe vendimmarrje, në nivelin lokal dhe atë qendror. Drejtorja Ekzekutive po ashtu ndau me të pranishmit informata lidhur me fushatën “Voto për më shumë gra në Parlament”, qëllimet dhe aktivitetet e saj.

Më 2 tetor, Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së u takua me përfaqësuesit e Komisionit Qendror Zgjedhor lidhur me zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Përgjatë këtij takimi, ajo përsëriti kërkesën për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në këto zgjedhje, si mbështetje ndaj thirrjeve të ngjashme të bëra nga Avokati i Popullit, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) si dhe Demokracia në Veprim (DnV).

Më 3 tetor, Shefja e Misionit Vëzhgues të Bashkimit Evropian në Kosovë, njëherësh anëtare e Parlamentit Evropian u njoftua për fushatën e RrGK-së “Voto për më shumë gra në Parlament”, gjatë takimit që pati me Drejtoreshën Ekzekutive të RrGK-së. Ajo theksoi në diskutim mungesën e zbatimit të LBGj-së nga partitë politike. Kurse, çështja e pjesëmarrjes së grave në politikë u ngrit nga ky mision përmes një kumtese për media, pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve. Zgjedhjet u vlerësuan të organizuara mirë dhe transparente, megjithatë u përmend fakti se partitë politike nuk kishin ndërmarrë masa të mjaftueshme për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor brenda listave partiake.

Përveç zbatimit të dispozitave të LBGj-së lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha ligjet dhe politikat publike, stafi i RrGK-së poashtu rishqyrtoi dhe komentoi 15 draft ligje, politika, dhe dokumente për të mbështetur shtimin e integritetit të perspektivës gjinore. RrGK ka mbështetur integrimin e perspektivës gjinore duke analizuar drafte të politikave publike (ligje, udhëzime administrative, strategji dhe plane veprimi) nga perspektiva gjinore, si dhe duke vlerësuar ndikimin e



mundshëm që ato mund të kenë në burra, gra, vajza dhe djem. Politikat dhe dokumentet që RrGK shqyrtoi dhe komentoi nga perspektiva gjinore gjatë vitit 2019 përfshijnë:

1. Kodi Penal i Kosovës
2. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Associmit 2019-2023
3. Hartimi i raportit për përmirësimin e OSHC-ve në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Associmit
4. Kodi Civil i Kosovës
5. Zyra për Qeverisje të Mirë - Hartimi i Strategjisë për të Drejtat e Njeriut
6. Projektligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
7. Agjenda Evropiane për Reforma
8. Draftimi i Ligjit të Punës
9. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
10. Rregullorja për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil në Republikën e Kosovës
11. Draft rregullorja e standardeve për organizimin e brendshëm, sistematizimin e punëve, si dhe bashkëpunimin në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura
12. Draft Rregullorja për orarin e punës dhe pushimin
13. Draftimi i Manualit të Institutit Evropian për Barazi Gjinore për ndëshkimin e seksizmit në vend të punës

14. Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejta të Njeriut - Raport i përbashkët i shoqërisë civile për të drejtat e njeriut
15. Raporti i Progresit për Kosovën 2019.

Komunikimi dhe bashkëpunimi i shtuar mes grave në politikë, organizatave të grave dhe votueseve për çështjet që ato konsiderojnë prioritete

Përmes Koalicionit për Barazi, Lobit dhe RrGK-së, gratë nga sfera politike, shoqëria civile dhe gratë votuese kanë bashkëpunuar rreth çështjeve të rëndësishme për to gjatë vitit 2019. Në bashkëpunim të ngushtë me gratë votuese nga komunat e tyre, anëtarët e Lobit avokuan për çështjet që gratë i konsiderojnë si prioritete. Gjithashtu, gjatë fushatës së lartpërmendur, vullnetarët nga RrGK dhe anëtarët e Lobit kanë shpërndarë fletushka të kësaj fushate duke shkuar edhe derë-më-derë për të diskutuar mbi rëndësinë e votimit të sa më shumë grave në parlament, Gjithashtu, gjatë këtij viti Lobi ka zhvilluar në total 51 takime me gratë politike, votuese dhe organizatave të shoqërisë civile.

Listën e këtyre iniciativave mund ta lexoni në Shtojcën 2 të këtij raporti.



Prizren, gjatë shpërndarjes së fletushkave të fushatës "Voto për më shumë Gra në Parlament"

Avokimi i filluar për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet

RrGK ka mbështetur dhe fuqizuar gratë për të identifikuar dhe avokuar për prioritetet e tyre. Kjo është arritur përmes granteve për anëtarët e RrGK për iniciativat e tyre të avokimit nëpërmjet FGK.

Fondi gjithashtu ka mbështetur përpjekjet e organizatave anëtare për të monitoruar dhe avokuar për zbatimin e ligjeve dhe politikave ekzistuese. RrGK ka inkurajuar OShCG -të që të bashkëpunojnë ngushtë me Lobin dhe me Koalicionin për Barazi. Gjatë këtij viti, Lobi ka pasur 62 iniciativa avokuese për çështjet të cilat gratë i shohin me prioritet.

Përmirësohet institucionalizimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator (BPGj) në Kosovë

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGj) është i rëndësishëm jo vetëm për rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, por edhe për ndarjen efikase dhe të barabartë të fondeve publike. Kështu, RrGK ka avokuar dhe mbështetur BPGj-në në Kosovë që prej vitit 2011. Në vitin 2019 RrGK u bë pjesë e një nisme rajonale me gjashtë organizata në vende të Ballkanit Perëndimor, si në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi, si dhe Moldavi, me



qëllim të ngritjes së kapaciteteve sa i përket BPGj-së, zhvillimin dhe forcimin e një rrjeti rajonal për BPGj dhe avokimin për politika më të përgjegjshme gjinore. Trajnimi i parë rajonal për trajnerët u mbajt më 18-21 nëntor në Shkup, përgjatë të cilit u ndanë koncepte dhe shembuj të BPGJ-së, siç janë vlerësimet e politikave gjinore, analiza e të hyrave nga buxheti gjinor, analiza e shpenzimeve buxhetore gjinore dhe analiza e përfituesve, buxheti gjinor kosto/benefit, si dhe analiza e ndikimit të buxhetit në kohë. Partnerët gjithashtu ndanë burimet dhe materialet nga përvojat e tyre të punës në BPGj. Një fushatë rajonale u promovua përmes rrjeteve sociale. Po ashtu, OshC-të në rajon u njoftuan me mundësinë për të aplikuar për punëtori dhe grante për të realizuar BPGj-në në komunitetet e tyre. Në Kosovë aplikuan 11 organizata. RrGK do të vazhdojë që të punojë me to në të ardhmen.



Shkup, gjatë Trajnimit të Trajnerëve mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor, ku prezent ishin shtatë organizata nga Ballkani Perëndimor dhe Moldavia.

Rritja e pjesëmarrjes së OShCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE

RrGK ka kontribuar në përfshirjen e disa organizatave anëtare në konsultimet mes nën komiteteve për Stabilizim-Asociim, të cilat janë zhvilluar duke i paraprirë dialogut teknik mes përfaqësuesve të BE dhe atyre të qeverisë së Kosovës. Me anë të platformës së konsultimit publik, të lansuar këtë vit nga qeveria e Kosovës, RrGK po ashtu ka konsultuar organizata të ndryshme në mënyrë që të adresohen kërkesat e tyre nga ana e institucioneve përkatëse. Më konkretisht, gjatë këtyre diskutimeve 10 organizata kanë pasur rast të kërkojnë ndërmarrje të masave për stabilizim në terma afatgjatë të strehimoreve të Kosovës, zbatim të Ligjit për Trashëgiminë si dhe përfshirje më të madhe të grave në procese vendimmarrëse. Gjatë vitit 2019, 10 organizata të grave nga Kosova kanë marrë pjesë në komentimin e dokumenteve për anëtarësim në BE. RrGK ka mbështetur ato në përgatitjen dhe dorëzimin e komenteve të përbashkëta gjatë këtyre proceseve.

Kështu, Rezoluta e Parlamentit Evropian për të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor u adaptua me përmbytje të disa pikave të sugjeruara nga RrGK, partnerët e saj në rajon, si dhe Fondacioni Kvinna till Kvinna. Rezoluta adreson dhunën me bazë gjinore, qasjen e mangët në drejtësi, pjesëmarrjen e ulët të grave në politikë si dhe përfaqësimin e ulët të grave në tregun e punës.



OShCG-të dhe gratë më të informuara rreth proceseve të anëtarësimit në BE, rolin e tyre dhe se si të angazhohen

Përmes platformës së konsultimit publik, RrGK ka arritur që t'i njoftojë të gjitha organizatat anëtare se ekzistojnë mënyra të ndryshme që ato të angazhohen direkt në komentimin dhe ofrimin e ekspertizës së tyre në sektorët përkatës. RrGK kërkoi komentet e anëtareve për Raportin e Progresit, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), si dhe Agjendën për Reforma Evropiane.

Përmirësimi i integritetit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre

Përgjatë vitit 2019 RrGK ka ofruar të dhëna dhe komente për disa politika dhe ligje, me qëllim integrimin e perspektivës gjinore në dokumente që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE. Kjo tregohet edhe përmes rezultateve të mëposhtme.



Dorëzimi i komenteve lidhur me dokumentet

RrGK, me anë të ekspertizës përkatëse, vazhdimisht ka ofruar komente dhe rekomandime në ligje, politika publike dhe dokumente të cilat ndërlidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE. RrGK ka bashkëpunuar me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe me Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE) për të përfshirë këto rekomandime në dokumentet relevante. Në total, RrGK ka komentuar në gjithsej 15 dokumente që kanë të bëjnë me ngritjen dhe përmirësimin e barazisë gjinore dhe të drejtave njerëzore të grave. Këtu janë përfshirë dokumentet si; Raporti i Progresit, si dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e Standardizimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Agjenda Evropiane për Reforma II.

Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të zyrtarëve të BE-së, Ministrisë së Integritimit, Mekanizmave Kombëtar për Barazi Gjinore si dhe ministrive të linjës lidhur me integritimin e perspektivës gjinore në dokumentet relevante për anëtarësim në BE

Zyrtarët e Ministrisë së Integritimit Evropian kanë theksuar gjatë konsultimeve publike, se e vlerësojnë lart angazhimin e RrGK-së në proceset e hartimit të dokumenteve të ndërlidhura me anëtarësimin e Kosovës në BE.

Gjatë vitit 2019, RrGK ka mbajtur 38 takime avokuese me zyrtarë në Kosovë dhe Zyrën e BE-së për t'i informuar ata verbalisht lidhur me pikat avokuese dhe rekomandimet e lidhura me barazinë gjinore.



Poashtu, RrGK këtë vit ka qenë e kontraktuar nga zyra e BE-së që të ofrojë trajnim dhe ndihmë teknike për delegacionin e BE-së në Kosovë për të kuptuar kontekstin e çështjeve gjinore në raport me vendin, Planin e Veprimit Gjinor III si dhe Integrimin e çështjeve gjinore në projektet/dokumentet relevante.

Përmirësimi i zbatimit të PVGj II

Për të zbatuar më mirë PVGj II, RrGK punoi drejt arritjes së rezultateve të mëposhtme.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve të BE-së lidhur me nevojën për angazhim më të fuqishëm politik, buxhet të mjaftueshëm dhe burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e PVGj II

RrGK ka avokuar në mënyrë të rregullt për përfshirjen e Planit të Veprimit Gjinor II në Kosovë. RrGK ofroi trajnime dhe ndihmë teknike për Zyrën e BE-së në Kosovë lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në projektet e kontraktuara dhe dokumentet relevante në linjë me objektivat e PVGj II. RrGK gjithashtu mbështeti integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit, gjë e cila është e paraparë në PVGj II.

RrGK vazhdimisht ka avokuar për një PVGj II edhe më të fuqishme, në kuptim të përmbajtjes, raportimit si dhe zbatimit të saj.

Përmirësimi i projektimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II

Në vitin 2019, RrGK është munduar që të arrijë përparim në këtë objektivë përmes rezultateve të mëposhtme.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit lidhur me përmirësimet e nevojshme në PVGj III

RrGK avokoi për këto rekomandime përmes takimeve avokuese me Komisionin Evropian në Bruksel, takimeve me delegacionet e BE-së në Kosovë dhe rajon, si dhe përmes bashkëpunimit me partnerët rajonalë.

RrGK u konsultua nga vlerësuesit e angazhuar në PVGj II për të informuar PVGj III. Në fund të vitit 2019, RrGK zhvilloi një analizë të politikave për t'i informuar akterët përkatës kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me mësimet e nxjerra nga PVGj II dhe përmirësimet e nevojshme për hartimin e PVGj III: *Në linjë me zotimet e BE-së për Barazinë Gjimore: Mësimet e nxjerra nga PVGj II për të informuar PVGj III*. Kjo u nda me zyrtarët e BE-së në Kosovë dhe në Bruksel.

Përmirësimi i transpozimit të *Acquis* të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës

RrGK dhe partnerët e saj nga rajoni shënuan përparimin drejt këtij objekti përmes rezultatit fillestar si vijon:

ABGj, MIE dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) janë më të informuara lidhur me nevojën për transpozim të përmirësuar të *Acquis* të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës

RrGK ka vazhduar bashkëpunimin me ABGj, MIE, dhe MPMS duke bashkëpunuar për transpozimin e *Acquis* të BE-së për Barazi Gjinore në Ligjin e Kosovës. RrGK dërgoi rekomandime politikash te MIE dhe MPMS, veçanërisht të lidhura me transpozimin e Direktivës së BE-së për balancin jetë-punë dhe futjen e saj në Ligjin e Punës, në bashkëpunim me Forumin Ekonomik të Grave. Gjithashtu, RrGK kontribuo në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Associmit, e cila poashtu përfshinte thirrjet për vëmendje ndaj pushimit të lehonisë, atësisë dhe atij prindëror, të cilat duhet patjetër të transpozohen saktë me direktivat përkatëse të BE-së.

Të Drejtat e Grave në Kujdesin Shëndetësor

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor dhe me kosto të përballueshme. Përderisa shëndeti riprodhues i grave duket të jetë fokusi i shumicës së aktiviteteve zhvillimore, RrGK konsideron mirëqenien e përgjithshme të grave po aq të rëndësishme. Edhe pse burimet për angazhim më të madh lidhur me përmirësimin e qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor mbeten të kufizuara, megjithatë disa përparime janë shënuar falë punës së anëtareve, mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës.

“Aleanca e Grave për Integrim” përmes nismës “Ngritja e vetëdijes rreth kujdesit shëndetësor për gratë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt dhe Lipjanit” ka mundur që në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë në Ferizaj, për gratë e këtyre komuniteteve të mbahen ligjërata lidhur me temat relevante, nga ekipi për edukim dhe promovim të shëndetit.

Përmirësimi i reagimit të zyrtarëve publikë dhe institucioneve shëndetësore ndaj shkeljes së të drejtave shëndetësore të grave

Drejt arritjes së kësaj objektive, është shënuar përparim siç vërehet edhe në rezultatet e poshtëshënuara:



Më shumë zyrtarë publik, gra, vajza dhe burra janë në dijeni për të drejtat e grave për kujdes shëndetësor dhe shkeljet e të drejtave të tyre

Mbështetur nga FGK, organizatat anëtare të RrGK-së, Psikoterapeutët në Veprim (PEA), Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK), Shoqata e Mamive të Kosovës, Shoqata e Grave për Integrim, Gruaja Bashkëkohore si dhe Handikos Mitrovica mbajtën gjithsej 17 takime me zyrtarë publik ku u diskutua për të drejtat shëndetësore të grave.

Rritja e qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor

RrGK ka shënuar përparim drejt arritjes së kësaj objektivie falë përpjekjeve të organizatave anëtare, të mbështetura nga FGK. PEA ka mundur kontrollin falas për 125 persona, prej tyre 99 gra. Kurse, 158 persona të tjerë u kontrolluan falas, përderisa kontrollet mjekësore do t'u bëhen në të ardhmen. Falë këtyre kontrolleve disa prej këtyre personave zbuluan që vuanin nga sëmundje për të cilat nuk kishin qenë në dijeni; kështu ata përfituan vëmendje të menjëhershme mjekësore.



Gratë dhe vajzat më të vetëdijshme për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

Falë mbështetjes së marrë nga FGK, 455 gra dhe vajza u këshilluan dhe u informuan për të drejtat e tyre për qasje në kujdes shëndetësor cilësor. Duke përfshirë këtu rreth 109 gra dhe vajza rome, ashkalike dhe egjiptane nga fshatrat e Lipjanit, Rahovecit dhe Ferizajt. Këto gra përgjatë aktiviteteve u njoftuan për rëndësinë e kujdesit intim, mundësitë për parandalimin e sëmundjeve si dhe Pap Testin. Gjithashtu, PEA ka mbështetur gratë shqiptare dhe serbe me nevoja të veçanta nga tetë fshatra të Komunës së Gjilanit. Ato mësuan më shumë rreth kujdesit shëndetësor dhe pastaj përfituan kontrolle mjekësore falas.

Me 26 tetor Jeta Vita organizoi marshin “Zbulimi i Hershëm – Mbijetesë” për të shprehur solidaritetin dhe për të rritur sensibilizimin për kancerin e gjirit në shoqërinë kosovare.



Gjithsej 500 persona përfituan këshilla dhe udhëzime mjekësore. OPDMK në Prizren mbajti ligjërata dhe takime këshilluese ku morën pjesë 61 persona. Handikos Mitrovica mbajti sesione terapeutike, takime dhe ligjërata për depresion për nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në të cilat 47 gra morën pjesë në këto takime të mbajtura në Krushë të Vogël. Po ashtu, kjo organizatë ofroi edhe ligjërata mbi kancerin e gjirit, vet-ekzaminimin e gjirit, kancer të mitrës, shtypjen e lartë të gjakut dhe diabetin. Për këto ligjërata të pranishme ishin 80 gra.

Ndërsa me 26 tetor, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita, për të 12-tën herë me radhë organizoi manifestimin kulturor-informativ, ku qytetarë të shumtë kanë marshuar së bashku me moton e organizatës: “Zbulimi i Hershëm = Mbijetesë” për të shprehur solidaritetin dhe rritur sensibilizimin për kancerin e gjirit në shoqërinë kosovare.



Njerëzit me aftësi kufizuara të ndryshme marrin pjesë në një aktivitet krijues të organizuar nga OPDMK, më 11 korrik në Prizren.

Më shumë gra avokojnë për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor cilësor

Gjithsej 163 gra u angazhuan për të avokuar rreth të drejtave të tyre shëndetësore, kjo falë mbështetjes së FGK-së. OPDMK takoi përfaqësuesit e Departamentit të Shëndetësisë në Prizren, për të avokuar për mjete financiare për tavolina hidraulike të cilat mund të përdoren nga gratë për kryerjen e kontrolleve gjinekologjike.

JETA PA DHUNË ME BAZË GJINORE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë një jetë të lirë nga dhuna me bazë gjinore. RrGK ka bërë progres drejt përmbushjes së këtij qëllimi, siç e ilustrojnë edhe të arriturat drejt rezultateve në vazhdim.

Zbatimi i përmirësuar i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë

Në vitin 2019, RrGK ka avokuar për disa ndryshime ligjore që do të kontribojnë në zbatimin e përmirësuar të kornizës ligjore, si dhe praktikat më të mira në adresimin e dhunës në familje. Që nga prilli i



Ariana Qosaj Mustafa,
kryetarja e bordit të RrGK
gjatë fjalimit në Forumin
Rajonal, tetor 2019



2019-ës, falë avokimit nga RrGK dhe anëtarët e saj, në përputhje me Konventën e Stambollit, dhuna në familje tani është një vepër penale në Kosovë. RrGK dhe anëtarët e saj gjithashtu avokuan me sukses për krijimin e një linje specifike buxhetore për financimin e strehimoreve, si dhe rritjen e alokimeve buxhetore për strehimore në vitin 2019. Për më tepër, Rrjeti dërgoi rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Megjithatë, për shkak të shpërbërjes së qeverisë, ky proces ka ngelur i pa përfunduar. Për të arritur këtë qëllim, RrGK gjithashtu bëri progres drejt rezultateve të mëposhtme.

Zgjerohen njohuritë lidhur me shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje, si dhe ndërgjegjësimi rreth përhapjes së dhunës në familje

Megjithëse, në këtë periudhë nuk është paraparë hulumtim i realizuar nga RrGK në lidhje me prevalencën e Dhunës në Familje. RrGK kishte një kontribut të madh në hulumtim të raportit për “Mirëqenien dhe Sigurinë e grave në Kosovë”, dalë nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Ky raport tregon se “gati dy e treta e grave të anketuara (64%) mendojnë se dhuna nga partnerët, personat e njohur apo të panjohur është shumë ose mjaft e zakonshme, dhe më shumë se



Adelina Berisha nga RrGK gjatë lansimit të raportit të OSBE mbi “Mirëqenien dhe Sigurinë e grave në Kosovë”, më 22 nëntor në Prishtinë.

një e katërta (27%) mendojnë se është shumë e zakonshme”. Tutje, raporti tregon se 54% e të gjitha grave thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga një partner i ngushtë që nga mosha 15 vjeçare. Në ceremoninë e lansimit të raportit, RrGK bëri thirrje që tu njihet puna dhe kontributi i strehimoreve dhe OJQ-ve të grave dhe që ky kontribut duhet të marrë mbështetje nga qeveria.

Institucionet dhe akterët e tjerë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore e dhunës në familje

RrGK zhvilloi takime avokuese me përfaqësues nga 13 institucione të ndryshme, ku ka diskutuar gjetjet mbi përhapjen e dhunës nga hulumtimi i RrGK-së *“Mjaft më me Arsyetime”* (2015), dhe përgjigjen institucionale ndaj dhunës, të detajuar në raportin e fundit të RrGK-së *“Nga Fjalët në Vepra”* (2017). Secilit institucion i janë ndarë rekomandime specifike për adresimin më të mirë të rasteve të dhunës në familje. Në vitin 2019, RrGK dhe anëtarët e saj gjithashtu përmirësuan edhe bashkëpunimin mes strehimoreve dhe Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), drejt mbajtjes më përgjegjëse institucionet në trajtimin e tyre ndaj personave që pësuan dhunë në familje ose me bazë gjinore. Nga ky bashkëpunim, tre raste iu referuan IAP-së për hetime të mëtejshme. Kjo punë u realizua me mbështetje nga UN Women.

RrGK dhe organizatat anëtare të saj të angazhuara në zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

RrGK ka qenë në krye të adresimit të padrejtësive ndaj personave që kanë përjetuar dhunë në familje. Për shembull, më 5 dhjetor, në një artikull të Kallxo.com tregohet se ishin vërejtur shkelje të rregullave të Kodit të Procedurës Penale në Gjilan. Në këtë rast, Gjykata e Gjilanit- dega në Viti, kishte ballafaquar viktimën e dhunës në familje me burrin e saj, i cili kishte ushtruar dhunën. Si pasojë e kësaj dhune të përjetuar, gruaja në fjalë kishte marrë lëndime, për të cilat i është nevojitur kujdesi mjekësor. Pasi që i biri i tyre kishte dashur ta dërgojë viktimën në shërbim mjekësor për trajtim, ushtruesi i dhunës e kishte ndaluar, duke ushtruar dhunë edhe ndaj tij. Ushtruesi i dhunës, sipas atikullit në fjalë është major në Forcat e Sigurisë së Kosovës. Më tej, sipas Kallxo.com, gjyqtari i këtij rasti Nexhat Aliu, kishte cekur se "...ne nuk e kemi thirrë [viktimën]. E ka pas një seancë përpara për dhunë në familje, ne nuk i kemi dërguar as ftesë; ka dashtë me ardh, ka dashtë me prezantu edhe ka prezantu, por ne nuk i kemi dërgu ftesë", ndërsa më vonë kishte deklaruar se "ajo është gruaja e tij dhe ne nuk jemi me shkatërru familje, jemi për me u mundu me arritë që ata me qenë bashkë prapë". Sipas nenit 70 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, fakti që kryesi ishte anëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës duhej të ishte konsideruar si një rrethanë rënduese gjatë marrjes së vendimit gjyqësor. Nuk duhet të ketë lehtësuar procedurat gjyqësore në favor të dyshuarit, siç duket se ka ndodhur në këtë rast. RrGK kërkoi që Gjykata Themelore në Gjilande- dega në Viti, ta trajtojë këtë rast sipas kornizës ligjore në fuqi. Gjithashtu u bëri thirrje organeve të drejtësisë të qëndrojnë prapa detyrave dhe obligimeve ligjore e të mos shkaktojnë ri-viktimizim dhe pajtim ndërmjet ushtruesve të dhunës dhe viktimave gjatë procedurave penale. Tendecat e tilla për pajtim

kanë pasur pasoja me fatalitet për gratë dhe vajzat, andaj duhet kujdes i shtuar dhe vlerësim i mirëfilltë i rrezikut në rastet e dhunës ndaj grave, thuhet në deklaratën e RrGK.

Rritja e performancës dhe cilësisë së shërbimeve të strehimoreve, veçanërisht në drejtim të rehabilitimit dhe riintegrit

Janë mbajtur disa punëtori me stafin e strehimoreve, me fokus në ngritjen e njohurive mbi rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe mbi kornizën ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje. Për më tepër, ekspertja Lepa Mladjenović, ka udhëhequr punëtori për stafin e strehimoreve dhe të qendrave ditore për metodat e rehabilitimit emocional të viktimave të dhunës në familje, si dhe ka ngritur shkathtësitë e ofruesve të këtyre shërbimeve për kujdes nga “shterimi emocional” dhe rëndësinë e mbikëqyrjes. Kjo nismë është mbështetur nga UN Women.

Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe vëmendjes së zyrtarëve dhe qytetarëve, lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

Ka pasur përmirësime në vëmendjen e zyrtarëve ndaj dhunës me bazë gjinore në vitin 2019, siç tregohet nga miratimi zyrtar i ndryshimeve ligjore të lartpërmendura drejt adresimit të dhunës me bazë gjinore. Që nga prilli 2019, dhuna në familje dhe ngacmimi seksual janë vepra penale, të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Është krijuar një linjë buxhetore për strehimore dhe qendra ditore që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Ka pasur edhe nisma për



të miratuar Konventën e Stambollit në Kushtetutën e Kosovës, megjithëse ky proces nuk është përfunduar para shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës.

RrGK gjithashtu vazhdoi avokimin për zbatimin e Kodit Penal dhe Buxhetit për vitin 2019 për strehimore, duke rritur ndërgjegjësimin e zyrtarëve dhe qytetarëve për nevojat e personave që kanë përjetuar dhunë. Në nëntor, RrGK bashkë me Grupin për Siguri dhe Barazi Gjinore (GSBGj), avokuan pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për të zbatuar buxhetin për strehimore dhe qendra ditore, siç përcaktohet në Buxhetin e vitit 2019. Më tej, GSBGj kërkoi shërbime për adresimin e dhunës seksuale dhe mbështetje për të mbijetuarit. Ata u bënë thirrje institucioneve përkatëse për të mbrojtur të drejtat duke siguruar trajnime të veçanta për të gjitha palët e interesuara të përfshira, për të ofruar mbështetje për të cilën të mbijetuarit kanë të drejtë juridike, si dhe ndërtimi i strehimoreve të veçanta për të mbijetuarit e dhunës seksuale me financim nga qeveria.

Është arritur përparim gjithashtu drejt këtij objekti përmes progresit në rezultatet e pritura në vijim.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre

Gjatë këtij viti RrGK, ka organizuar ekspozitën “Dhuna nuk Fshehet Mrena Mureve” në tetë komuna të Kosovës: në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Drenas. Më shumë se 1900 qytetarë të Kosovës, e vizituan këtë ekspozitë. Aty patën mundësinë të mësojnë për shtrirjen e dhunës në familje, bazuar në hulumtimin e RrGK “Mjaft më me Arsyetime” (2015), si dhe mbi rolin e institucioneve që kanë për obligim të ndihmojnë viktimat e dhunës në familje. RrGK ka pasur më shumë se 122 paraqitje mediatike, për të ngritur vetëdijen te qytetarët lidhur me dhunën në familje.

Pas raportimeve mediatike mbi dhunën seksuale ndaj të miturës në Drenas, RrGK ishte pjesë e protestave të organizuara në Prishtinë dhe në Drenas, ku mijëra qytetarë ngritën zërin për ta dënuar dhunën e shkaktuar dhe për të kërkuar përgjegjësi nga institucionet vendore, duke dëshmuar kështu për ngritjen e vetëdijes qytetare dhe interesim për të ndër marrë aksione për të adresuar këtë çështje.



*Fjalimet në hapjen e ekspozitës së RrGK
“Dhuna nuk Fshehet Mrena Mureve” me datë
15 qershor.*

Më 8 mars u mbajt sërish marshi tradicional “Marshojmë S’Festojmë” ku mbi 500 qytetarë ngritën zërin për barazi gjinore, luftim të diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore.

Poashtu, me mbështetje të FGK-së, organizatat anëtare të RrGK-së, Luna, Medic Kosova, Djepi i Buzëqeshjes dhe Gruaja Bashkëkohore, kanë kontribuar në vetëdijesimin e 226 grave dhe burrave në komunitetet e tyre rreth dhunës me bazë gjinore.

Është rritur vëmendja e institucioneve në trajtimin e dhunës me bazë gjinore

RrGK me përvojën e saj ka kontribuar në punëtori që kanë synuar rritjen e njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe mbrojtësve të viktimave për zbatim më të mirë të dispozitave të reja të Kodit Penal lidhur me dhunën në familje, duke u përqendruar në dhunën fizike. Një punëtori u mbajt në Gjakovë, me ç’rast RrGK ofroi sesione për përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë nga rajoni, lidhur me ndryshimet në Kodin Penal. Po ashtu, RrGK monitoroi disa seanca gjyqësore në proces, për të dokumentuar shembuj të praktikave institucionale të mira dhe të këqija, të cilat do të plotësojnë raportin e ardhshëm monitorues në vitin 2020.



Përmirësimi i politikave dhe procedurave për adresimin e ngacmimit seksual

Siç u cek më lart, nga prilli i këtij viti, falë avokimit të RrGK-së ngacmimi seksual është definuar si vepër penale, në Kodin Penal. Për këtë nismë RrGK ka punuar për dy vite radhazi, për ta krijuar një definicion që do të jetë në pajtim me kërkesat e Konventës së Stambollit. Përpjekje të vazhdueshme ka pasur edhe për arritjen e rezultatit të mëposhtëm.

Koordinimi mes OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucionet publike, si dhe vendet tjera të punës është përmirësuar në aspektin e instalimit të mekanizmave më të mirë për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual

Me mbështetjen e vazhdueshme të RrGK-së ka vazhduar punën grupi punues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” për të krijuar mekanizma për raportimin e ngacmimeve seksuale.

Përmirësohet përkrahja institucionale dhe publike për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

RrGK dhe anëtarët e saj vazhduan mbështetjen për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Katër organizata anëtare që janë të licencuara për të ofruar mbështetje emocionale dhe psikologjike për të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë vazhduar punën edhe përgjatë vitit 2019. Përkrahja po ashtu ka vazhduar edhe përmes Komisionit për Verifikim, i cili në përputhje me ligjin jep pensione për këto të mbijetuara. RrGK ka mbikëqyrur dhe përkrahur punën e këtij komisioni.

FGK ka mbështetur Medica Kosovën dhe Djepin e Buzëqeshjes për të zbatuar iniciativën për të kontribuar në njohjen e statusit dhe të drejtën e pensionit për të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës. Të dhënat për këtë pikë u mbledhën nga organizatat anëtare, RrGK dhe një numër i aktorëve të tjerë. Për më tepër, ato ndihmuan tetë gra për të kompletuar aplikacionin e tyre për përfitimin të statusit dhe të drejtën e pensionit.

Poashtu në mars, RrGK ka reaguar ndaj deklarimeve të pabaza të bëra nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) lidhur me kompensimin e personave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë. KMDLNJ përmes mediave deklaroi se “ka pasur manipulim me numrin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës” dhe se “pa asnjë fakt apo listë të bazuar në prova është spekuluar një numër prej 20, 000 viktimave të dhunës seksuale, e cila është keqpërdorur dhe abuzuar si nga politikanët po ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile”. Tutje, në konferencën “Progresi dhe Sfidat” të organizuar nga Komisioni Qeveritar për



Drejtorja Ekzekutive e RrGK, Igballe Rogova, gjatë panelit në konferencën “Progresi dhe Sfidat”

Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, paneliste ishte edhe Drejtorja Ekzekutive, Igballë Rogova, e cila lavdëroi punën e komisionit dhe të organizatava të grave që ofrojnë shërbime për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, mbështeti vendimet e të mbijetuarave/ve për të vendosur vet nëse ata/ato duan të kërkojnë të drejtën në pension, gjithmonë duke bërë thirrje që të ndalohej stigma ndaj tyre, si dhe kërkoi mbështetje më të madhe institucionale për anëtarët e komisionit.

Fuqizimi Ekonomik i Grave

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike. Progres i mëtejshëm është bërë drejt këtij qëllimi, siç shihet nga hapat e ndërmarrë drejt realizimit të objektivave dhe rezultateve vijuese.

Përmirësimi i kushteve për pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore

Në vitin 2019, RrGK së bashku me organizatat e saj partnere dhe anëtarët e Koalicionit rajonal kundër diskriminimit gjinor ndaj grave në punë, mbajtën 34 takime për të planifikuar dhe ndërmarrë avokim të përbashkët drejt zbatimit të legjislacionit kundër diskriminimit. Si rezultat i këtyre takimeve, u ndërmorën shtatë nisma të përbashkëta për avokim, duke rezultuar në ndryshimin e dy politikave, të cilat mund të përmirësojnë kushtet për pjesëmarrje të barabartë të grave në punë në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, me mbështetjen e partnerëve, shtatë raste të diskriminimit me bazë gjinore



në punë u raportuan tek zyrtarët. Shumica e përpjekjeve nën këtë objektiv u mbështetën nga Bashkimi Evropian dhe u bashkëfinancuan nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Përparim i mëtejshëm është bërë drejt këtij qëllimi, siç shihet nga hapat e ndërmarrë drejt realizimit të objektivave dhe rezultateve vijuese.

Institucionet dhe akterët kryesor më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit me bazë gjinore në vendin e punës në Kosovë dhe mënyrat për ta adresuar atë

RrGK, së bashku me partnerët e saj rajonal, publikoi shtatë raporte mbi diskriminimin me bazë gjinore dhe punën, përfshirë një për secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe një raport rajonal. Në këto raporte diskutohet shkalla e diskriminimit me bazë gjinore, përgjegjësitë institucionale dhe përmban rekomandime të qarta për të gjithë akterët përkatës. Këto raporte u prezantuan palëve të interesuara në të gjithë rajonin gjatë 42 takimeve të ndryshme. Për më tepër, mediat kanë mbuluar rreth 55 raste që kanë të bëjnë me diskriminimin ndaj grave në punë, duke kontribuar në vetëdijesimin publik.



Rritja e vetëdijes në mesin e palëve të interesit, përfshirë zyrtarët, OSHC-të dhe sindikatat lidhur me konceptet e diskriminimit dhe si të përmirësohet zbatimi i tyre

Rrjeti në bashkëpunim me partnerët e saj rajonal zhvilloi më shumë se 104 takime për ndërgjegjësimin e palëve të interesuara. Duke marrë pjesë në panele, konferenca dhe seminare të ndryshme, përfaqësuesit e këtij koalicioni kanë ngritur vetëdijen e palëve të interesit për konceptet e diskriminimit dhe mënyrat institucionale për parandalimin e tij.

Rritja e disponueshmërisë të informatave lidhur me hendekun gjinor të pagave, ekonominë joformale dhe skemat e sigurimeve shoqërore

Gjatë hulumtimit mbi diskriminimin me bazë gjinore në tregun e punës, RrGK dhe partnerët e saj në rajon identifikuan nevojën për më shumë informacione lidhur me hendekun gjinor të pagave. RrGK ka avokuar tek institucionet e Kosovës, si dhe zyrtarët e BE-së, lidhur me nevojën për të përmirësuar disponueshmërinë e të dhënave për këto tema të rëndësishme, nga një perspektivë gjinore.



RrGK gjatë lansimit të raportit “Diskriminimi me Bazë Gjinore në Punë” më 11 prill në Prishtinë.



Përmisimi i qasjes në drejtësi në rastet e diskriminimit gjinor në punë

Së bashku me partnerët në rajon, RrGK lehtësoi qasjen e grave në drejtësi duke u ofruar këshilla juridike për raportimin e diskriminimit me bazë gjinore në institucionet përkatëse. Ndërsa partnerët e mbështetur nga RrGK kanë ofruar ndihmë në shtatë raste; në vitin 2020 ky koalicion i udhëhequr nga RrGK do të sigurojë përfaqësim ligjor dhe do të monitorojë rastet e diskriminimit me bazë gjinore drejt përmirësimit të trajtimit të këtyre rasteve.

Rritja e përqindjes së grave që kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi

Megjithëse, asnjë iniciativë e mbështetur nga RrGK gjatë vitit 2019 nuk kontribuoi drejtpërdrejt në rritjen e përqindjes së grave për qasje në trashëgiminë ose pronën e tyre, disa anëtare të RrGK kanë kontribuar drejtpërdrejt përmes vetëdijesimit drejt rezultatit vijues.

Më shumë qytetarë të vetëdijesuar lidhur me të drejtat e grave në trashëgimi dhe pronësi

Falë përkrahjes nga Fondi i Grave të Kosovës, organizata anëtare e RrGK-së, Shoqata e Grave "Aureola" punoi drejt ngritjes së vetëdijes për të drejtat e trashëgimisë së grave. Rreth 49 persona (41 gra dhe 8 burra) kanë përfituar drejtpërdrejt nga kjo nismë. Shumë përfitues të tjerë indirekt përfituan falë metodës së ndërgjegjësimit dhe shkëmbimit të informacionit përmes platformave televizive lokale. Kjo iniciativë



ndikoi që qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të kuptojnë më mirë rëndësinë e së drejtës së grave në trashëgimi si dhe ndikoi në fuqizimin ekonomik të grave.

Përmirësimi i perspektivës gjinore në reformat lidhur me Procesin e Anëtarësimit në BE

Progres i mëtijshëm është bërë në këtë drejtim, siç shihet me hapat e ndërmarrë drejt arritjes së rezultateve vijuese.

Përmisimi i monitorimit të politikave dhe programeve të BE-së në Kosovë nga perspektiva gjinore

RrGK ka kontribuar për të informuar Raportin e Kosovës për vitin 2019 dhe 2020, Agjendën Evropiane të Reformës dhe disa konsultime të BE-së dhe qeverisë me shoqërinë civile në lidhje me procesin e Stabilizim-Asociimit. Në fund të vitit 2019, është rritur numri ku përmenden të drejtat e grave dhe barazisë gjinore në 82 herë, në dokumentet lidhur me Anëtarësimin në BE. Në përgjithësi, 17 sektorë të ndryshëm përfshinë një perspektivë gjinore në dokumentet e tyre institucionale dhe akteve nënligjore. Për më tepër, 55% e rekomandimeve të RrGK-së për përfshirjen e një perspektive gjinore u pranuan në Raportin e Vendi 2019 dhe 47% u përfshinë në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së



Stabilizim-Asociimit. Komentet e RrGK përfshijnë propozimet për integrimin e perspektivës gjinore në fushat që mund të kontribuojnë në fuqizimin ekonomik të grave.

Përmirësimi i Qasjes në Edukim Cilësor dhe të Ndjeshëm Gjinor

Pas vendimit nga anëtarët e RrGK-së, Përmirësimi i Qasjes në Edukim Cilësor dhe të Ndjeshëm Gjinor është rreshtuar qartazi si program i ri në Strategjinë e RrGK-së. Lidhur me këtë program, edhe pse në pritje të burimeve, megjithatë në vitet në vijim RrGK planifikon që të punojë drejt përmbushjes së dy objektivave: rritjen e numrit të qendrave për kujdesin ndaj fëmijëve në proporcion me fëmijët në nevojë; mbikëqyrjen; dhe përmirësimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore nga një perspektivë gjinore.

VLERËSIMI I PUNËS SË RrGK

RrGK monitoron dhe vlerëson punën e vet në disa mënyra. RrGK ka zhvilluar një Databazë të Monitorimit dhe Vlerësimit me qëllim që të përcjellë progresin në indikatorët e rezultateve të menjëhershme (output), objektivat dhe nivelin e ndikimit me kalimin e kohës, bazuar në Strategjinë organizative të RrGK-së. Stafi e përditëson rregullisht databazën me të dhëna lidhur me indikatorët, gjë që mundëson raportimet semestrale tek anëtarët dhe këtë raportim vjetor. Për më tepër, në çdo takim

të organizuar gjatë vitit 2019, anëtarët e RrGK kanë vlerësuar punën e RrGK përmes pyetësorëve (rezultatet e plota janë në dispozicion sipas kërkesës). Gjatë Kuvendit Vjetor të RrGK-së, anëtarët në mënyrë anonime e vlerësuan shumë pozitivisht punën e RrGK. Gjithashtu, punën e RrGK-së e kanë vlerësuar shumë pozitivisht edhe përkrahësit financiar. Më poshtë janë disa nga komentet e tyre:

"Dobishëm- Shërbimet e RrGK janë shumë të dobishme për ne sepse na ndihmojnë të bashkëpunojmë më shumë pe organizatat tjera".

"Shumë e dobishme, takimet e Rrjetit na mbajnë aktive dhe të informuara".

"Shumë mirë – Shumë të përpikët në dhënien e informatave".

"Arritjet më të mëdha të Rrjetit kanë qenë ndikimi në fuqizimin e anëtarëve të RrGK-së, [informimin e ligjeve të reja, sensibilizimin ndaj dhunës në familje, etj]."

"Arritjet më të mëdha të Rrjetit kanë qenë lobimi dhe përkushtimi në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të strehimoreve."

RAPORTI FINANCIAR I RrGK PËR

Raporti financiar në vijim përmban informata për periudhen 1 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019, lidhur me përkrahësit, projektet dhe fondet e pranuar dhe të shpenzuara të RrGK-së.

Donatorët	Titulli i Inicativës	Fondet e bartura	Fondet e pranuar	Totali i fondeve	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2020
Agjencioni Austriak për Zhvillim 8299-01/2018 (01.01.2018-31.12.2020)	Avancimi i Inicativave për të Drejtat e Grave	51,649	310,000	361,649	148,586	213,062
Agjencioni Austriak për Zhvillim 6513-00-2019(01.01.2019-30.04.2019)	Integrimi i Perspektivës Gjinore		1,170	1,170	1,170	-


External Action of the European Union 2018/394402 (23.03.2018-28.02.2021)	Fuqizimi i rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile në luftimin e Diskriminimit dhe avancimin e të drejtave të grave në punë	121,786	438,427	560,213	246,912	313,301
External Action of the European Union 2018/404-465 (20.12.2018-20.12.2022)	Fuqizimi i pjesmarrjes së Grave në Politikë	135,334		135,334	98,674	36,660
Kvinna till Kvinna Foundation KO01SID16-31005 (01.01.2019-31.12.2020)	Avancimi/Fuqizimi i Barazisë Gjinore në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE	-	46,738	46,738	44,687	2,051

Kvinna till Kvinna Foundation BN55SID16 -2019 (01.04.2019-31.12.2019)	Hulumtim i përqëndruar në BE “Financimi i lëvizjeve të grave në Ballkanin Perëndimor-		28,524	28,524	22,871	5,653
EU Office in Kosovo PA(19.10.2018-18.09.2019)	Asistencë për integrimin gjinor në Programin IPA për Kosovë 2016		19,988	19,988	19,988	-
Un Women 2018 PCA - 000105171 (31.12.2019-01.12.2019)	Iniciativa “Ndal dhunës ndaj grave”		45,000	45,000	45,000	-
Un Women 2019 PCA - 00113666 (05.11.2019-31.05.2020)	Fuqizimi i rinisë për një Ardhmëri të Qetë, Progres dhe		14,890	14,890	1,527	13,363

	të Qëndrueshme në Kosovë					
Center for Research and Policy Making CRPM / ADA -GRB, Grant Contract: 2841-00/2019(01.11.2019-31.07.2022)	Rrjeti i Mbikëqyrjes së Buxhetit Gjinator në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë		25,371	25,371	933	24,438
Autonomous Women's Centre AWC / ADA-GBV 8374-02/2019 (01.12.2019-31.12.2022)	Institucionalizimi i shërbimeve të rehabilitimit të cilësisë dhe integritetit për të mbijetuarit e dhunës		32,467	32,467	1,305	31,162

Unicef	Kontrata e shërbimit - Ekspertizë për Trajnimin e Socializimit Gjinor		1,200	1,200	1,200	-
Altrusa	Punë praktike për vajza	46	2,121	2,167	1,285	881
Individual Donations	Fondi i Qëndrueshmërisë	3,263	1,999	5,261	1,418	3,844
Totali		312,077	967,894	1,279,970	635,555	644,415

Shpërndarja e shpenzimeve për vitin 2019



Raporti i Audituesit të pavarur mbi auditimin e pasqyrave financiare

Rrjeti i Grave të Kosovës

Bordit të Drejtorëve

Kadri Gjata K-ll nr. 8,

Prishtinë

Opinionin

Kemi audituar pasqyrat financiare të Rrjeti i Grave të Kosovës RrGK, respektivisht pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parash, për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabil.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të organizatës me 31 dhjetor 2019, të performancës financiare për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe Ligjin 06/l-043, "Për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare".

Baza për opinionin

Auditimi është kryer në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Përgjegjësitë tona janë përshkruar në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare të këtij raporti*.

Konfirmojmë pavarësinë nga organizata në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët. Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe që kanë përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa.

Besojmë se evidenca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinionin.

Theksim i çështjes

Në tërheqim vëmendjen në Shpalljen "Parimi i vijimësisë së afazimit" (Fq.17.) dhe "Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit" (Fq.23) të pasqyrave financiare, që përshkruajnë efektet e përhapjes së pandemisë COVID-19 në vijimësinë e aktiviteteve të tanishme të organizatës dhe në periudhat e ardhshme raportuese.

Opinionin ynë nuk është ndikuar nga këto çështje.

Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgaditur mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për syllën likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë së vet për 12 muajt e ardhshëm.

Auditimi nuk ka identifikuar ekzistencën e ngjarjeve apo kushteve të cilat krijojnë dyshime mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe personave në qeverisje për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SHSH-NVt dhe për kontrollin për të cilat drejtimi mendon se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa të meta materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse drejtimi ka për qëllim të likujdojë ose të ndalpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprorë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare, si tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditimit që përfaqëson opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas standardeve gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalië mund të paraqiten si pasojë e mashtimit ose gabimit dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të bashkuara, mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me standartet, ne kemi ushtruar gjykimin profesional duke ruajtur skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidencë të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të anomaliave materiale për shkak të mashtimit është më i lartë se ai i shikuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, mospërfshirjen e qëllimshme, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollin e brendshëm që janë të rëndësishme për auditimin në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që janë të përshatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efikasitetin e kontroleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.
- Përfundojmë mbi përshatshmërinë e hipotezës së vijimësisë së përdorur nga ana e drejtimit dhe bazuar nga evidencën e përfshirur e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit, në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare, ose në rast se një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditimit.

Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

-Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen, nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Kemi komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfarëdo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Prishtinë 21.05.2020.

Audit Office Shpk

Ulpiana DZ/7 II-B

Shaban Muharremi, Auditor Ligjor

044 112-036.



RRETH NESH

Bordi Drejtues i RrGK

Ariana Qosaj Mustafa, *Kryetare e Bordit, Drejtore e Programit, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED)*

Belgjzare Muharremi, *Drejtore Ekzekutive, Dera e Hapur*

Besnik Leka, *Koordinator i Projektit, CARE International në Ballkan*

Jeta Krasniqi, *Menaxhere e Projektit, Instituti Demokratik i Kosovës*

Magbule Hyseni, *Udhëheqëse e Departamentit, Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)*

Bordi Këshillëdhënës i RrGK

Delina Fico, Rachel Wareham, Behar Selimi, Vjosa Dobruna, Marte Prekpalaj, Shqipe Malushi, Lepa Mladjenovic

Stafi i RrGK në vitin 2019

Igballe (Igo) Rogova, *Drejtore Ekzekutive*

Nicole Farnsworth, *Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimeve*

Besa Shehu, *Menaxhere Financiare & Administrative*



Zana Rudi, Menaxhere e Programit
Adelina Berisha, Zyrtare për Avokim dhe Hulumtim mbi Dhunën me Bazë Gjinore
Adelina Trshana, Koordinatore e Projektit
Alba Loxha, Zyrtare për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Komunikim
Desumena Laçi, Zyrtare e Financave
Diellza Olluri, Koordinatore e Fondit të Grave të Kosovës
Donjetë Berisha, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun
Etleva Malushaj, Koordinatore dhe Mobilizuese për Filantropi dhe Vullnetarë
Gentiana Murati, Menaxhere e Granteve
Gresë Sermaxhaj, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun
Iliriana Banjska, Koordinatore e Projektit (janar – mars)
Jehona Tupalla, Mirëmbajtja e zyrës
Klarisa Fetahu, Koordinatore e Projektit (mars – nëntor)
Mirjeta Dibrani, Asistente e Granteve
Nerina Guri, Hulumtuese / Koordinatore e Projektit
Nertila Qarri Gërguri, Koordinatore e Projektit (janar – gusht)
Shpend Bërbatovci, Koordinator për Marrëdhënie me Publikun (mars – qershor)
Valmire Rashiti, Koordinatore e Projektit / Asistente Ligjore
Valon Sejdiu, Koordinator për Marrëdhënie me Publikun (shtator – dhjetor)
Vesa Zatriqi, Koordinatore e Projektit



Vullnetaret/ët dhe Praktikantët/ët e RrGK në 2019

Secila iniciativë e RrGK-së ka përfshirë disa vullnetarë dhe praktikantë. Ndoshta jo të gjithë janë të përfshirë këtu. RrGK dëshiron të njoh kontributin e tyre të rëndësishëm.

Vullnetarë këtë vit janë: Mathilda Anna Carolina van der Zwaag (janar – maj); Mira Tan (qershor – korrik); David JJ Ryan. Ndërkaq, profesoresha dhe ekspertja për marrëdhënie me publikun, Martine Beachboard, qëndroi në RrGK gjatë periudhës gusht – tetor, duke ndihmuar stafin dhe aftësuar organizatat anëtare në këtë fushë.

Ndërsa praktikantë (me pagesë) që kanë kontribuar në RrGK është: Viona Krasniqi dhe Rudina Voca.

Hulumtuesit dhe anketuesit e RrGK

Jemi shumë mirënjohëse për hulumtuesit dhe anketuesit të cilët kanë punuar pa pushim për të përfunduar hulumtimin (në renditje alfabetike):

Besarta Breznica (maj – gusht)

Donjeta Arifi (maj – gusht)

Leonora Aliu (maj – gusht)

Liridona Sijarina (maj – gusht)

Qendresa Trshana (maj – gusht)

Taya Kohnen (gusht – dhjetor)



Përkrahësit/et individual/e të RrGK

Personat në vijim (në renditje alfabetike) kontribuan në përkrahjen e RrGK-së dhe punës së saj.

Ada Shima, Afërdita Thaqi, Alba Loxha, Albane Ismajli, Albulena Shala, Alison Greig, Altina Bytyqi, Amantina Pervizaj, Ana Jara Gómez, Anduena Beqiri, Angela Otten, Angelika Arutyunova, Arbër Sylejmani, Ariana Qosaj – Mustafa, Arjeta Murati, Arlinda Kadriu, Ashley Faye, Aurora Maxharraj, Besa Shehu, Besnik Leka, Betim Dibrani, Colleen Moore, Dea Pallaska O'Shaughnessy, Delina Fico, Dhurata Prokshi, Diellza Krasniqi, Diellza Shabanaj, Edona Krasniqi, Eglantina Shala, Elisabeth Kaestli, Ellen Lamberg, Elza Kabashi, Ermira Cacaj, Ermira Gashi, Ethel Farnsworth, Etleva Durmishi, Fatime Jasiqi, Frank & Sue Farnsworth, Gentiana Murati Kapo, Hana Marku, Hans Fridlund, Hata Dibrani Sopjani, Hatixhe Gashi, Hermonda Kalludra, Hidajete Vokshi, Hikmete Xharra, Ideal Hoxha, Igballe Rogova, Iliriana Banjska, Ilmie Berisha, Itziar Mujika, Jelena Bulatovic, Jennine Mol, Jeta Krasniqi, Kada Heta, Kathleen Noh, Katja Goebbels, Krenar Basha, Laura Prescott, Lendi Mustafa, Lepa Mladjenovic, Liz Perryman, Liza Kutllovci, Loresa Statovci, Lumnije Mehmeti, Magbule Hyseni, Makfirjete Limoni, Mame Faye Rexhepi, Margen Cuko, Mariana Qamile Roed, Martine Robinson Beachboard, Merita Shasivari, Merve Atila, Mevlude Murtezi, Miranda Avdullahu, Morgan Stanley, Naime Bllaca, Nicole Farnsworth, Njomëza Zejnullahu, Nuriye Cacaj, Rachel Cleary, Rrezarta Veseli, Sadete Gerbeshi, Sanija Murati, Sasha Linney, Shega Emmini, Shengyle Bektashi, Sherafedin Shehu, Shpresa Gosalci, Shqipe Mehmeti, Shqipe Murati, Shqipe Pantina, Sian Jones, Tracy Aron, Ulpiana Lajçi, Valbona Bajrami, Valdete Idrizi, Valon



Badivuku, Vedat Gashi, Venera Çoçaj, Vlerime Krasniqi, Vlora Bllaca, Xhevrije Doroci, and Zorica Bulatovic.

Organizatrat Anëtare të RrGK-së

#	Organizata	Komuna	Përfaqësuesi/ja
1	Aksioni për Nënë dhe Fëmijë	Prishtinë	Vlorian Molliqaj
2	Aleanca e Grave për Integritet	Lipjan	Adelina Qorraj-Emini
3	Alma	Pejë	Shemsije Seferi
4	Alter Habitus	Prishtinë	Eli Gashi
